# DËSHMI ARKIVI

**A-423694**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Publikohen çmimet e 10 produkteve, konsumatorët do t'i shohin në platformë, për të mësuar se cili super market i ka më lirë – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/publikohen-cmimet-e-10-produkteve-konsumatoret-do-ti-shohin-ne-platforme-per-te-mesuar-se-cili-supermarket-i-ka-me-lire/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 7 shtator 2026, 05:12:52 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 31 gusht 2026, 13:09:08 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d0e49e22070f677697f8f2c8b52970729040765100be9f037b146e2e781bfbb1` |
| TEKSTI | `f989396e6ce017d86d95a5fda2d34ca629414cc0271c58bffe2d84076e9c2e49` |
| PAMJA | `df91d9a2e9467355fc9dbcfaccbb0746fa4be265a500c09e91c887c099167d12` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b5a07444896aaac58cf64ef904b53d772f3f4db30e62460cd0ae62db89d3bc60` |
| E MËPARSHMJA | `7bc5d05266f0eb545da000cc49e9e4d2dcf74a71ead05767262d85c59e0a7f86` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b5a07444896aaac58cf64ef904b53d772f3f4db30e62460cd0ae62db89d3bc60`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

produkteve të shportës në një platformë online, që quhet “Price Watch Albania”.

Në këtë portal, supermarketet kryesore në vend do të publikojnë çdo ditë çmimet për 10 produkte, në këtë fazë të parë të zbatimit.

*“Kemi një ligj për mbrojtjen e konsumatorit. Në bazë të këtij ligji, subjektet duhet të publikojnë çmimet e tyre për publikun. Mbi këtë bazë, ne do t’ju kërkojmë të gjithë pikave të shitjes që të raportojnë çmimet e shitjes me pakicë të produkteve bazë të shportës. Do të nisim fillimisht me 10 produkte bazë dhe do ta kërkojmë këtë raportim të çmimeve te rrjetet kryesore të supermarketeve në vend. Më pas ngadalë, me kalimin e kohës do të zgjerohet edhe më tej lista e produkteve, për të bërë të mundur që aty të publikohen të gjithë çmimet e produkteve të shportës”, thotë Enkelejd Musabelliu, zv.ministër i Ekonomisë.*

Edhe pse qeveria pranon që tregu vendas karakterizohet nga çmime të larta, ajo shpjegon se në një ekonomi të lirë, nuk mund të ndërhyjë për të përcaktuar marzhe fitimi.

*“Ne si ministri pranojmë dhe jemi njësoj të shqetësuar si edhe publiku për nivelin e përgjithshëm të çmimeve në Shqipëri, që është deri diku i lartë në krahasim me fuqinë blerëse të qytetarëve shqiptarë. Është pak e vështirë për shtetin në një ekonomi të lirë tregu që të kontrollojë dhe përcaktojë nivelin e çmimeve”, thotë Musabelliu.*

Përmes kësaj nisme, Ministria e Ekonomisë synon jo vetëm të bëjë transparencë të çmimeve për konsumatorët, por edhe të nxisë


5 Elbasani nuk fal! Egnatia pëson humbjen e parë të sezonit



NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

transparencë të çmimeve për konsumatorët, por edhe të nxisë konkurrencën mes operatorëve, gjë që në fund mund të çonte në një ulje të çmimit.

*"Ne kemi marrë si modele Hunharinë, Sopanjën,. Portugalinë, Italinë, që kanë një platformë që krahason çmimet e produkteve të ndryshme në pika të ndryshme tregtimi, në mënyrë që edhe konsumatori të jetë më i informuar se cila pikë e tregtimit ka çmime më të ulëta, por edhe publiku më i gjerë të jetë i njohur dhe të ketë transparencë për nivelin e përgjithshëm të çmimeve për produktet bazë të shportës. Ne do të përpiqemi të analizojmë të gjithë zinxhirin e një produkti. Synimi është për të kuptuar në cilën hallkë ndodh rritja e çmimit dhe për të adresuar më pas këtë problematikë përmes politikave ligjore që mund të marrë qeveria", sqaron Musabelliu.*

Me integrimin në tregun e përbashkët europian, sipas ministrisë, subjektet tregtare shqiptare mund të ndjejnë presionin e konkurrencës dhe të rishikojnë çmimet për produkte apo shëbime të ndryshme.

#çmime #ushqime

**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Më shumë video



VIDEO

**Nis viti i ri shkollor, Skënder Hita mesaz...**

Xhuljana Zhuleku · 3 minuta më parë



VIDEO

**Alarmi i rremë për bombë në shkollën...**

Xhuljana Zhuleku · 10 minuta më parë



VIDEO

**Nafta "kapërcen" 230 lekë për litër,...**

Xhuljana Zhuleku · 37 minuta më parë

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE

**Lajme**
Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

**Programe**
Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

**Rrjeti**
Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

**Ligjore**
Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.